

Formular për SYLLABUS të Lëndës:

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Ekonometri dhe Metoda Empirike
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	o
Viti i studimeve:	1
Numri i orëve në javë:	2
Vlera në kredi - ECTS:	8
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	
	<i>Në këtë lëndë studentët do të njihen me ekonometrine dhe metodat emirike te aplikuara kryesisht në sektorin financiar. Me saktësisht, studentet do te njihen me analizen e regresionit, metodat tjera kuantitative dhe kualitative, dhe metodat joparametrike/programim linear te aplikuara ne problemet e sektorit financiar. Aplikimi I metodave kuantitative dhe kualitative kerkimore, metodologjia e te shkruarit akademik perbejne shtyllat kryesore te lendes.</i>
Qëllimet e lëndës:	
	<i>Qëllimi i këtij moduli është të pajis studentët me njohuri e shkathtësi për hulumtime te problemeve, kryesisht ne sektorin financiar. Ky modul do të përfshij ligjëtara dhe ushtrime në aplikimin e metodave empirike. Në kuadër të metodave empirike studentët do të njihen me ekonometrinë (por edhe me metodat e programimit linear ne menyre me siperfaqesore) si një discipline me aplikim të gjerë, posaçërisht në punën shkencore ne sektorin financiar. Qëllimi i këtij moduli është ofrimi i nje paraqitjeje më të detajuar te koncepteve ekonometrike; ofrimi i bazave te analizes ekonometrike duke u fokusuar ne metodologjine e regresionit shumë-faktorial; ofrimi i te kuptuarit gjithpërshires të analizes ekonometrike mbi problemet ne sektorin financiar; perfitimi i njohurive mbi nje pakete kompjuterike për analize te te dhënave dhe njohurite per te perpiluar nje projekt ku studenti pritet qe te ndërtojë një model ekonometrik me një lidhje funksionale që është konsistente me teorine, të mbledhë të dhënat përkatëse, te beje vlerësimin e modelit, te identifikojte problemet e mundshme statistikore, te beje interpretimin e rezultateve. Projekti duhet te permbaje nje përmbledhje</i>

	<i>te çështjes që është duke u hulumtuar, përcaktimin e objektivave dhe hipotezave për të testuar; prezantimin e teorisë dhe shqyrtimit të aspekteve përkatëse teorike; shtjellimi i problematikes në aspektin e nderlidhjeve empirike; specifikimi i modelit për t'u vlerësuar, të dhënat dhe burimi i tyre; prezantimi i rezultateve të vlerësimit, dhe statistika përmbledhëse; statistikat e testeve diagnostike, diskutimi i testeve dhe procedurave për zgjidhjen e problemeve ekonometrike; konkluzionet, implikimi i rezultateve në teori dhe politika ekonomike/sector financiar; krahasim me rezultatet e tjera empirike.</i>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<i>Përmes këtij moduli studentët do të njihen me bazat konceptuale të hulumtimit kuantitativ (konceptet, definicionet, teoritë dhe modelet), dhe kualitativ, të kuptuarit e koncepteve në ekonometri dhe ato me sipërfaqesore në metodat tjera empirike.</i>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Javë	Gjithsej
Ligjërata	2		2
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1		1
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	0.5		0.5
Detyra të shtëpisë	1		1
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	6		6
Përgaditja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet, prezentimet etj	1		1
Totali			
Metodologjia e mësimdhënies:	<i>Çdo javë do mbahen nga 2 ore ligjërata. Gjatë ligjëratave një pjesë e rëndësishme e kohës do t'i kushtohet diskutimeve në klasë dhe punën seminarike. Çdo orë do të jepen detyra, të cilat pastaj do të</i>		

	<i>diskutohen në orën tjetër. Detyrat do të kenë rëndësi për vlerësim. Metoda e punës do të përqendrohet në ligjerata, dhe pjesëmarrjen aktive të studentëve në procesin e mësimit, me prezantime individuale e grupore, etj.</i>
Metodat e vlerësimit:	<i>Vlerësimi i studentëve bëhet përmes: pjesëmarrjes aktive në ligjerata dhe ushtrime (10%), Puna Seminarike (50%) dhe provimit final (40%). Kriteret e kalueshmërisë: 91-100 poena=nota 10; 81-90 poena=nota 9; 71-80 poena=nota 8; 61-70 poena=nota 7; 51-60 poena=nota 6; nën 50 poena=nota 5.</i>
Literatura	
Literatura bazë:	<i>Xhaferi, Besa (2013), Hyrje në ekonometri, Universiteti i Tetovës: Tetovë.</i> <i>Matthews, B. & L. Ross (2010), Metodat e hulumtimit: Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane. Tiranë: CDE.</i> <i>Dougherty (2016), Introduction to Econometrics, Oxford University Press.</i>
Literatura shtesë:	<i>Rachev et al. (2006), Financial Econometrics: From Basics to Advanced Modeling Techniques, John Wiley & Sons: NJ.</i> <i>William W. Cooper, Lawrence M. Seiford and Kaoru Tone (2006), Data Envelopment Analysis: A Comprehensive Text with Models, Applications, References and DEA-Solver Software, Springer.</i>
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Procesi kërkimor 1: Përkufizimi i idesë për t'u hulumtuar; burimet e informatave; mbajtja e shënimeve për punimin shkencor; struktura e punimit kërkimor. - Përzgjedhja e punimeve seminarike
<i>Java e dyte</i>	Procesi kërkimor 2: Procesi i të shkruarit; premiset e shkrimit kërkimor; citimet; referencat; bibliografia. Menaxhimi me numra; përpilimi i tabelave; përpilimi dhe llojet e grafikoneve - Përzgjedhja e punimeve seminarike
<i>Java e trete:</i>	Natyra dhe supozimet e analizës së regresionit; Modeli i

	regresionit nje- dhe shume-faktorial: metodologjia e vleresimit dhe problemet e vleresimit - Perzgjedhja e punes seminarike
<i>Java e katert:</i>	MZKM (OLS) dhe supozimet e modelit te regresionit klasik lineare; Vleresimi intervalore dhe testimi i hipotezave; Analiza e regresionit multivariabel: problemi I vleresimit dhe inferenca statistikore - Perzgjedhja e punes seminarike
<i>Java e peste:</i>	Multikolineariteti, Heteroskedasticiteti, Autokorrelacioni, Distribuimi Normal, Forma Funksionale dhe Stabiliteti Strukturore i modelit
<i>Java e gjashte:</i>	Hyrje ne modele me te dhena panel, pool, seri kohore dhe modele tjera te aplikuara; Modelet e regresionit me variabla 'dummy'
<i>Java e shtate:</i>	Perdorimi i 'software'-ve ne ekonometri
<i>Java e tete:</i>	Perdorimi i 'software'-ve ne ekonometri
<i>Java e nente:</i>	Problemet tjera gjate vlersimit te modelit ekonometrik dhe metodat per zgjidhje
<i>Java e dhjete:</i>	Shembuj te aplikuar ne sektorin financiar
<i>Java e njembëdhjete:</i>	Shembuj te aplikuar ne sektorin financiar
<i>Java e dymbëdhjetë :</i>	Metodat e Programimit Linear 1
<i>Java e trembëdhjetë :</i>	Metodat e Programimit Linear 2
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Pune seminarike - prezantime
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Pune seminarike - prezantime

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Konform statutit të UP-së.